

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Tremujori IV, 2015

Tiranë, më 04 Mars 2016: Në tremujorin e katërt 2015, Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) arriti 102,3 % kundrejt tremujorit të parë 2011 (Tremujori i parë 2011=100).

Në tremujorin e katërt 2015 ndryshimi vjetor i indeksit të kushtimit në ndërtim (për banesa) është 0,03 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 0,1 %.


Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2014, rritjen më të madhe e ka patur grupi "Shpenzime për paga" me 1,6 %.

Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2014, ulja më e madhe vjetore vërehet në grupin "Shpenzime materiale" me 2,3 %, pasuar nga grupet "Shpenzime për energji" me 0,8 %, "Shpenzime transporti" me 0,7 %, etj.

Në tremujorin e katërt 2015 ndryshimi tremujor i indeksit është - 0,1 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2015, uljen më të madhe e ka patur grupi "Shpenzime materiale" me 0,7 %. Brenda këtij grupi uljen më të madhe e patën nëngrupet "Materiale ndërtimi" dhe "Materiale elektrike dhe komunikim" me 0,8 % secili. Indeksi i çmimeve të grupeve "Shpenzime transporti" dhe "Shpenzime makinerie" është ulur respektivisht me 0,3 % dhe 0,1 %, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Indeksi i grupit "Shpenzime të tjera" u rrit me 0,7 %, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, pasuar nga grupi "Shpenzime për paga" me 0,2 %.

Fig. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) sipas tremujorëve



Tab. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Tremujori i parë 2011=100

%

Kodi	Grupet	Peshat	IV-12	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14	II-14	III-14	IV-14	I-15	II-15	III-15	IV-15
	Totali (1+2+3+4+5+6)	100,0	101,0	101,5	101,7	101,6	102,2	101,7	102,0	102,1	102,3	102,1	102,4	102,5	102,3
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	55,2	99,9	100,1	100,3	101,2	100,7	99,8	100,8	101,3	101,6	99,0	99,7	100,0	99,3
	a. Materiale ndërtimi	42,3	99,7	99,6	100,4	101,6	100,8	99,9	101,1	101,6	101,8	98,5	99,0	99,3	98,6
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	6,7	98,7	101,6	100,7	100,1	102,0	99,7	100,1	101,4	101,7	100,8	101,9	102,5	102,3
	c. Materiale hidro-sanitare	6,2	103,1	102,0	98,9	99,1	99,2	99,5	99,5	99,6	100,2	100,4	101,6	101,8	101,0
2	Shpenzime për paga	24,6	99,8	99,9	101,7	102,6	102,4	103,5	103,9	103,8	104,0	104,1	104,4	105,4	105,6
3	Shpenzime makinerie	8,3	102,9	102,9	105,2	104,6	104,4	102,1	102,9	103,1	103,0	102,8	103,1	103,0	102,9
4	Shpenzime transporti	5,3	102,7	102,4	103,7	102,8	102,6	102,8	103,1	103,4	103,3	103,1	102,9	102,8	102,5
5	Shpenzime për energji	2,1	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	100,3	99,4	99,4	99,4	99,4
6	Kosto të tjera	4,5	101,2	103,7	103,1	101,7	102,1	105,6	104,8	103,6	103,9	107,6	106,7	105,4	106,1

Tab. 2. Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Kodi	Grupet													%
		IV-12/IV-11	I-13/I-12	II-13/II-12	III-13/III-12	IV-13/IV-12	I-14/I-13	II-14/II-13	III-14/III-13	IV-14/IV-13	I-15/I-14	II-15/II-14	III-15/III-14	IV-15/IV-14
	Totali (1+2+3+4+5+6)	0,5	1,2	1,0	0,5	1,2	0,2	0,2	0,5	0,1	0,4	0,4	0,4	0,03
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	-1,6	0,3	-0,3	0,1	0,8	-0,3	0,5	0,1	0,9	-0,8	-1,1	-1,3	-2,3
	a. Materiale ndërtimi	-2,0	-0,3	-0,4	0,0	1,1	0,3	0,7	-0,1	1,0	-1,4	-2,0	-2,2	-3,2
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	-2,5	2,3	1,6	0,8	3,4	-1,8	-0,6	1,3	-0,3	1,1	1,8	1,1	0,6
	c. Materiale hidro-sanitare	2,2	2,1	-1,9	-1,0	-3,8	-2,4	0,6	0,5	1,0	0,9	2,1	2,2	0,8
2	Shpenzime për paga	-1,6	-0,9	1,1	1,4	2,6	3,6	2,1	1,1	1,6	0,6	0,6	1,6	1,6
3	Shpenzime makinerie	2,8	2,0	3,2	0,7	1,5	-0,8	-2,1	-1,5	-1,3	0,7	0,2	0,0	-0,1
4	Shpenzime transporti	2,4	1,9	2,0	0,4	0,0	0,4	-0,6	0,5	0,6	0,3	-0,2	-0,6	-0,7
5	Shpenzime për energji	0,3	0,3	0,3	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,9	-0,8	-0,8	-0,8
6	Kosto të tjera	2,5	2,5	2,2	1,4	0,9	1,9	1,6	1,8	1,8	1,9	1,8	1,7	2,1

Tab. 3 . Ndryshimet tremujore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa)

Kodi	Grupet													%
		IV-12	I-13	II-13	III-13	IV-13	I-14	II-14	III-14	IV-14	I-15	II-15	III-15	IV-15
	Totali (1+2+3+4+5+6)	-0,1	0,5	0,2	-0,1	0,6	-0,5	0,3	0,1	0,2	-0,2	0,3	0,1	-0,1
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	-1,2	0,1	0,2	0,9	-0,5	-0,9	1,0	0,5	0,3	-2,5	0,7	0,3	-0,7
	a. Materiale ndërtimi	-1,9	-0,1	0,8	1,2	-0,8	-0,9	1,2	0,5	0,2	-3,2	0,5	0,3	-0,8
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	-0,6	3,0	-0,9	-0,6	1,9	-2,3	0,4	1,3	0,3	-0,9	1,0	0,6	-0,1
	c. Materiale hidro-sanitare	3,0	-1,1	-3,0	0,2	0,1	0,3	0,1	0,1	0,6	0,2	1,3	0,2	-0,8
2	Shpenzime për paga	-1,3	0,0	1,9	0,9	-0,2	1,1	0,4	-0,1	0,2	0,1	0,3	0,9	0,2
3	Shpenzime makinerie	-1,0	0,0	2,2	-0,5	-0,2	-2,2	0,8	0,1	-0,1	-0,2	0,3	-0,1	-0,1
4	Shpenzime transporti	0,2	-0,3	1,3	-0,8	-0,2	0,2	0,2	0,3	-0,1	-0,1	-0,2	-0,1	-0,3
5	Shpenzime për energji	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,8	0,0	0,0	0,0
6	Kosto të tjera	0,9	2,5	-0,5	-1,4	0,4	3,4	-0,8	-1,2	0,3	3,5	-0,9	-1,2	0,7

Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjerë joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. IKN duke filluar nga tremujori i parë 2011 llogaritet me shportën e re të materialeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimi., Tremujori i parë i vitit 2011 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 73 zëra nga të cilat 68 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mblidhen nga 138 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 50 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Për llogaritjen e Indeksit të Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) përdoret formula e Laspeyres:

$$I_{0t}^L = \frac{\sum_{i=1}^n \left(\frac{P_t^i}{P_0^i} \times w_0^i \right)}{\sum_{i=1}^n w_0^i} \times 100$$

Ku:

I_{ot} = Indeksi i periudhës t krahasuar me periudhën bazë 0

P_t^i = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën t (periudha korente)

P_0^i = Çmimi për njësi i artikullit i në periudhën 0 (periudha bazë)

w_0^i = Pesha e artikullit i në periudhën bazë

Rishikimi

Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë etj.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me tremujorin e mëparshëm.